KOMUNIKATË PËR WEB

Rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës 2022

28.12.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës 2022.

Statusi i pronësisë së shtëpive dhe banesave

Sa i përket shkallës së pronësisë së shtëpive dhe banesave, 95.1% e ekonomive familjare kishin në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat, 1.4% e ekonomive familjare ishin qiramarrës ose nën qiramarrës që paguajnë qira me normën e tregut , për 0.1% të ekonomive familjare akomodimi është marr me qira me një çmim më të ulët të tregut , ndërsa për 3.4% të ekonomive familjare akomodimi ofrohet falas.

Shkalla e pronësisë së shtëpive dhe banesave



Lloji i ndërtesës së banimit

Rreth 93.5% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në shtëpi të veçuar, të ndarë në vete, 1.6% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në shtëpi gjysmë të ndarë dy banesa, 1.8% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më pak se 10 banesa, ndërsa 3.1% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më shumë se 10 banesa.

Lloji i ndërtesës së banimit të individëve në ekonomitë familjare



Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate

Rreth 73.4% e ekonomive familjare ishin në gjendje të përballojnë mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate, përderisa për 26.6% të ekonomive familjare ishte e pa përballueshme mbajtja e shtëpisë ngrohtë në mënyrë adekuate.

Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate



Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës 2022, vizitoni: **https://ask.rks-gov.net/Themes/LivingConditions**